

## THIRRJE

Për pjesëmarrës në trajnime për mbulimin mediatik të çështjeve të sigurisë

Analytica Think Tank ([www.analyticamk.org](http://www.analyticamk.org)) shpall thirrje për pjesëmarrës në trajnime për mbulimin mediatik të çështjeve të sigurisë. Analitika është institucion i pavarur, jofitimprurës i dedikuar në përmirësimin permanent të demokracisë dhe qeverisjes në Maqedoni si dhe në vendet e tjera të rajonit. Ky projekt ka për qëllim mbështetjen dhe zhvillimin e raportimit të balancuar të bazuar në të dhëna të çështjeve që kanë të bëjnë me sektorin e sigurisë në Maqedoni.

Trajnimet do të zhvillohen një herë në muaj në periudhën tetor 2014 – prill 2015 nga ana e stafit të Analitikës dhe ekspertëve të jashtëm. Përveç metodave klasike arsimore të bazuara në qasje teorike, trajnimet do të përfshijnë edhe diskutime interaktive, ushtrime praktike (individuale dhe grupore), raste studimore, si dhe të shkruarit tekste mbi tema të caktuara. Pjesëmarrësit do të kenë mundësi të shkruajnë artikujt e tyre mbi çështjet e sigurisë të cilat do të publikohen në një platformë online e zhvilluar nga Analitika.

Temat që do të përfshihen janë:

- Hyrje në sektorin e sigurisë të Maqedonisë;
- Metodologjia e hulumtimit për gazetarë;
- Mbikëqyrja e sektorit të sigurisë;
- Informatat e klasifikuara dhe mbrojtja e të dhënave;
- Reformat në sektorin e sigurisë në Republikën e Maqedonisë;
- Buxhetet e institucioneve të sektorit të sigurisë;
- Siguria ndërkombëtare.

Kushtet për pjesëmarrje:

- studentë të gazetarisë, të sapodiplomuar apo gazetarë të rinj;
- të jeni të interesuar mbi çështjet e sigurisë;
- njohje e mirë e gjuhës angleze;
- gatishmëri për angazhim dhe pjesëmarrje në secilin trajnim;
- gatishmëri për të shkruar artikuj gazetaresk në tema të ndryshme në konsultim me stafin e Analitikës.

Ligjëratat do të jenë në gjuhën angleze dhe maqedonase. Shpenzimet për të marrë pjesë në kurset trajnuese do të mbulohen nga organizatorët. Pas përfundimit të suksesshëm të trajnimeve pjesëmarrësit do të pajisen me një certifikatë.

Të gjithë të interesuarit duhet të dërgojnë një **CV dhe Letër Motivuese** në e-mail adresën elektronike [mlebovska@analyticamk.org](mailto:mlebovska@analyticamk.org) më së voni deri më **26 tetor 2014**. Vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të ftohen për intervistë.

Më shumë informata rreth punës së Analitikës në çështjet e sigurisë mund të gjeni në:  
[http://analyticamk.org/index.php?option=com\\_content&view=article&id=122&Itemid=57](http://analyticamk.org/index.php?option=com_content&view=article&id=122&Itemid=57)

Projekti financohet nga Qendra e Gjenezës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura DCAF.